

GRANTET PËR VETËPUNËSIM:

PASQYRA E DHJETËVJEÇARIT TË KALUAR



HYRJE

Papunësia e lartë në Maqedoninë e Veriut ka shtyrë qeveritë e ndryshme të ndërmarrin masa për të reduktuar këtë fenomen. Një nga këto masa është iniciativa e Agjencisë për Punësim, e cila për vite të tëra ka shpallur thirrje të hapura për mbështetje të personave të papunë për vetëpunësim, me qëllim nxitjen e ndërmarrësisë dhe uljen e papunësisë. Kjo mundësi është ofruar për disa grupe të caktuara, duke përfshirë: të rinjtë deri në moshën 29 vjeçare, individët me aftësi të kufizuara, burrat deri në moshën 60 vjeçare, gratë deri në moshën 58 vjeçare, etj.

Nëpërmjet kësaj programe fituesit e grantit kanë përfituar trajnim disa ditorë mbi sipërmarrësinë dhe zhvillimin e aftësive të biznesit, vauçer për krijimin e një biznes plani dhe mbështetje për regjistrimin e bizneseve, repsketivisht firmave, mjete të pakthyeshme (grant) në vlerë prej 307.500 denarë (prej vitit 2024 kjo vlerë është rritur në 399.750 denarë) ose deri në 615.000 denarë nëse është themeluar nga person juridik prej dy partnerësh, si dhe 3.000 denarë për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të regjistrimit të kompanisë. Grantet janë paguar duke mbuluar shpenzimet e përfituesit të grantit të cilat janë lidhur me blerjen e pajisjeve ose materialeve të gatshme, në pëputhje me specifikat e biznesit përgjegjës. Personat që kanë përfituar njëherë nga kjo programë nuk e gëzojnë të drejtën për aplikim të dytë në programën për vetëpunësim.


Instituti IDEA ka bërë kërkesë për informacion me karakter publik deri tek Agjeniconi për Punësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut duke kërkuar të dhënat e nevojshme për këtë analizë, dhe ka pranuar përgjigje me të dhënat e kërkuara për periudhën 2014–2023. Analiza përshkruese e paraqitur në këtë dokument synon të nxisë debat mbi efektin e granteve për vetëpunësim si dhe masave tjera që synojnë uljen e papunësisë në përgjithësi, në mënyrë që të shqyrtohet efekti dhe cilësia e këtyre masave si dhe të ngjallen ide për përmirësimin e tyre, respektivisht në saje të masave të reja për vetëpunësim të qeverisë aktuale.

Numri i përfituesve ndër vite

Nga viti 2014 deri në vitin 2023 nga grantet për vetëpunësim kanë përfituar gjithësej 14.090 persona, prej të cilëve **62.37%** janë meshkuj dhe **37.62%** janë femra. Moshë mesatare e përfituesve të granteve për vetëpunësim është 35 vjeç. Siç mund të shihet në Figurën 1, numri i përfituesve të granteve për vetëpunësim ka shënuar rritje të vazhdueshme ndër vite, edhe atë prej mesatarisht 9.5%. Për shembull, në vitin 2014 janë miratuar gjithësej 931 grante ndërsa në vitin 2023 ky numër është rritur në 2.113, apo një rritje prej 126.96% krahasuar me vitin 2014.

Viti i vetëm në të cilin ka pasur rënie të numrit të granteve të pëfrituara është 2018, ku numri i granteve të dhëna është zvogëluar për 242 grante krahasuar me vitin paraprak, apo një rënie prej -18.97%. Në përgjithësi, në njërën anë shihet qartë një përkushtim i vazhdueshëm i qeverive për ta forcuar këtë masë për zbutjen e papunësisë, ndërsa në anën tjetër vërehet një senzibilizim i konsiderueshëm i njerëzve të papunë dhe kategorive të caktuara që gëzojnë të drejtën për shfrytëzimin e kësaj të drejte, duke përfiturar çdo vit e më shumë grante.


Figura 1. Numri i granteve të dhëna ndër vite, 2014-2023



Përfituesit e granteve sipas njesisë rajonale

Siç mund të shihet në Figurën 2, më së shumti grante janë ndarë në Qytetin e Shkupit, Tetovë dhe Kumanovë, edhe atë 5,401 grante apo 38.33% e granteve totale. Në anën tjetër, më së paku grante, apo 235 grante, janë ndarë në Kratovë, Krushevë dhe Makedonski Brod, të cilat përbëjnë vetëm 1.67% të granteve.

Figura 2. Përfituesit e granteve sipas njesive rajonale, 2014-2023




Përfituesit e grantit sipas moshës dhe etnisë

Si për meshkujt ashtu edhe për femrat moshë mesatare e përfituesve të granteve është 35 vjeç. Në anën tjetër, moshë mesatare e përfituesve të granteve të etnisë maqedone është 35.5 vjeç, ndërsa ajo e përfituesve të etnisë shqiptare është 34.2 vjeç.

Analiza e të dhënave tregon që nga numri total i përfituesve të granteve për vetëpunësim, 63.46% të përfituesve të granteve në dhjetë vitet e fundit janë të etnisë maqedonase, 31.64% janë të etnisë shqiptare dhe 4.90% janë të etnive apo pakicave tjera.

Figura 3. Përfituesit e granteve për vetëpunësim sipas etnisë në 10 vitet e fundit



I rëndësishëm është fakti që dhe pse shqiptarët përbëjnë diku 24.3% të popullsisë rezidente, ato përbëjnë 31.6% të përfituesve të granteve. Ky disproporcion mund të jetë reflektim i papunësisë më të theksuar tek popullsia rezidente shqiptare e cila shpëtimin nga papunësia e kërkon në vetëpunësim; tendencave më të theksuara kulturore për ndërmarrësi; por edhe reflektim i ekonomisë gri, e cila përmes granteve mund të jetë formalizuar. Megjithatë, shpërndarja e granteve për vetëpunësim nuk ka pasur kuota etnike.

Grantet sipas veprimtarisë

Tabela 1 përmbledh 10 veprimtaritë më të shpeshta në të cilat janë themeluar kompanitë të cilat kanë përfituar grante nga viti 2014 deri në vitin 2023, dhe të cilat përbëjnë pothuajse 40% të granteve të cilat janë dhënë. Siç mund të shihet, 3 veprimtaritë më të shpeshta janë sallonet e bukurisë, mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike, dhe gastronomia, të cilat përbëjnë 21.5% të granteve të përfituara. Këto veprimtari në përgjithësi kanë barriera të ulëta të hyrjes në treg, siç është kapitali relativisht i ulët, gjë që shpjegon edhe tendencën e lartë për të themeluar kompani në këto lëmi. Megjithatë, veprimtaritë në të cilat një pjesë e madhe e kompanive janë themeluar janë të lidhura me kërkesën e drejtëpërdrejtë konsumatore dhe si të tilla janë relativisht të prekura nga volatiliteti i ekonomisë.


Tabela 1. Dhjetë veprimtaritë më të shpeshta grantiste

Veprimtaria	Numri	Përqindja
Sallone të bukurisë	1,223	8.67%
Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike	992	7.00%
Restorante dhe ambiente të tjera për përgatitjen dhe servirjen e ushqimit	834	5.90%
Tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, kryesisht të ushqimeve, pijeve dhe duhanit	467	3.31%
Prodhim i mobiljeve të tjera	423	3.00%
Tregti me pakicë e veshjeve-dyqane të specializuara	357	2.50%
Punime të tjera përfundimtare ndertimi	333	2.36%
Montimi i mbulesave të dyshemesë dhe mureve	316	2.24%
Prodhimi i bukës; ëmbëlsirat e freskëta (torte, ëmbëlsira) dhe biskota (kapcakes)	312	2.21%
Suvatim	303	2.15%

Statusi aktual i kompanive përfituese të granteve

Nga analiza e të dhënave të marrura nga Agjencioni për Punësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut, mes tjerash kemi analizuar edhe statusin e kompanive që kanë përfituar grante për vetëpunësim. Nga numri total i bizneseve të krijuara nëpërmjet granteve për vetëpunësim në 10 vitet e fundit, 74.10% e tyre janë aktive, 24.95% janë mbyllur, 0.68% janë në procedurë të mbylljes dhe 0.28% janë para mbylljes.

Figura 4. Statusi i kompanive përfituese të granteve për vetëpunësim




Shikuar më detajisht sipas vitit të themelimit, pasqyra është edhe më e qartë: kompanitë të cilat janë themeluar në vitet e herëshme kanë shkallë më të lartë të familemtimit. Për shembull, siç mund të shihet në Figura 5, 60.47% e kompanive (apo 561 kompani) të cilat kanë përfituar grante në vitin 2014 kanë falimentuar dhe janë fshirë nga Regjistri Qendror ose janë në proces të falimentimit. Kjo shkallë bie në vitet vijuese, ku në vitin 2015 kemi 50.69%, në vitin 2016 52.55%.

Ajo që bie në sy është se mbi 17% e kompanive të themeluara në vitin 2021 janë fshirë nga Regjistri Qendror apo janë në proces të falimentimit. Arsyet e fshirjes nga Regjistri Qendror duhet të hulumtohen më tej me analizë më të thuktë kualitative për të parë mundësitë e adresimit të problemeve strukturale që çojnë në një shkallë të tillë të dështimeve të kompanive grantiste.

Analiza e vitit 2014 tregon që mosha mesatare e themeluesve të kompanive të cilat kanë dështuar është 37 vjeç, ndërsa e atyre të cilat ende janë aktive është 34.5 vjeç. Pra pronarët e kompanive të cilat kanë dështuar janë mesatarisht 2.5 vite më të moshuar në krahasim me themeluesit e kompanive të cilat janë ende aktive. Edhe në aspekt të gjinisë, 66.07% e bizneseve të falimentuara ose në proces të falimentimit janë themeluar nga themelues meshkuj, ndërsa 33.93% janë themeluar nga themelues femra.

Figura 5. Statusi i kompanive përfituese të granteve sipas vitit në të cilin kanë përfituar grantin



Përfundim dhe rekomandime

Instituti IDEA rekomandon:

- Të rritet monitorimi dhe mbështetja e bizneseve. Kjo mund të bëhet duke siguruar komunikim të vazhdueshëm në mes të grantistëve dhe institucioneve/organizatave të cilat do të ofronin trajnime të vazhdueshme dhe konsulenca të rregullta mbi menaxhimin dhe sipërmarrësinë, gjë që do të kontribonte në rritjen e qëndrueshmërisë dhe mbijetesës së tyre. Po ashtu, programa mund të ri-dizajnohet duke paraparë mundësi për round të dytë financimi për kompanitë të cilat tregojnë potencial rritje.
- Të rritet transparenca sa i përket përzgjedhjes së përfituesve. Këtu kemi parasysh drojën që mos të bëhen mallverzime tek ndarja e granteve, duke instaluar mekanizma dhe kritere edhe më strikte që grantet të mos shkojnë dy herë të e njëjta familje, por tek ata që me të vërtetë kanë nevojë dhe posedojnë ide të qartë mbi biznes planin e tyre. Këtu mund të kontribojë shumë transparenca dhe publikimi i emrave dhe mbiemrave të përfituesve në webfaqen e Agjencisë.
- Përmirësimi i performanës së vet programës. Kjo arrihet duke bërë një analizë të detajur mbi mungesat e tregut dhe profesioneve deficitare dhe stimulimin e njerëve të papunë drejt atyre profesioneve, duke i trajnuar dhe aftësuar në atë drejtim.
- Rritja e senzibilizimit mbi vet programën. Edhe pse kjo masë ka filluar të zbatohet për herë të parë në vitin 2004, pra njëzet vitë më parë, ne vlersojmë që nevojitet një ndërgjegjësim dhe fushatë më e madhe senzibilizuese në mënyrë që të informohen sa më shumë njerëz të papunë mbi këtë mundësi dhe të njejtët të inkurajohen që ta shfrytëzojnë mundësinë.



Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike – IDEA është “think tank” i krijuar në mars të vitit 2023 në Shkup, me mbështetjen e European Endowment for Democracy.

Në esencë, ne besojmë se forca e demokracisë tonë dhe cilësia e politikave ekonomike janë ngushtë të lidhura me angazhimin dhe pjesëmarrjen tonë demokratike. Ky besim i palëkundur ushqen qëllimin tonë, si ekip i përkushtuar për të kontribuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të demokracisë dhe politikave ekonomike në Maqedoninë e Veriut. Ne e përfytyrojmë Maqedoninë e Veriut si një shtet anëtar progresiv, liberal dhe rezilient i Bashkimit Evropian i cili është i ndërtuar mbi gjithëpërfshirje, inovacion dhe qëndrueshmëri. Ne jemi këtu për ta avancuar demokracinë dhe për të nxitur zhvillimin!

www.idea.org.mk

Tetovska 33/2/7, Skopje, Republic of Macedonia

+389 70 985 729

